

FJALA E DEPUTETES MERITA BAKIU

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar qytetarë,

E kujtoj herën e fundit kur fola nga kjo foltore, jo më shumë se 2 muaj më parë. Ndërsa sesioni parlamentar është i ri dhe sapo jemi kthyer nga pushimet, hallet e shqiptarëve janë po ato, nuk mbarojnë kurrë, por me “ndihmën dhe bekimin e kësaj qeverie” ato shtohen çdo ditë. Varfëria është një temë për të cilën flasim kryesisht kur ngjarjet tragjike të tilla si ato që kemi parë kohët e fundit, të krimit në familje dhe problemeve të thella sociale na tërheqin vëmendjen. Pastaj e shtyjmë mënjanë, e varrosim, themi se nuk është mendjemprehtësi politike të flasësh për këtë, por nuk ka temë që është më adekuate dhe më e vërtetë sesa kjo.

Ju flisni për suksese në turizëm, por nuk shikoni se sa familje shqiptare nuk mundën t’i çonin fëmijët e tyre asnjë ditë të vetme për pushime, për shkak se i kanë të numëruara të ardhurat deri në qindarkën e fundit. Ju flisni për suksese në turizëm, por nuk shikoni sesa familje shqiptare nuk mundën t’i çonin fëmijët e tyre as edhe një ditë me pushime, për shkak se i kanë të numëruara të ardhurat deri në qindarkën e fundit. Ju flisni për suksese në arsim, por harroni se suksesi juaj i vetëm ishin ato duartrokitjet false dhe boshe ne Pallatin e Kongreseve, në të ashtuquajturin “Kongresi i Arsimit”. Si një ishmësuese për 28 vjet me radhë nisma m’u duk pozitive si fillim para se të shikoja se si zoti Kryeministër nuk u kursye ta kthente as atë podium në podiumin e tij politik dhe elektoral për interesa të ngushta të tij dhe të partisë.

Arsimi, ashtu si Shqipëria, nuk janë as blu, as mavi, ato janë kuq e zi dhe janë çështje të një rëndësie madhore. Jo më kot nuk pashë në ato rreshta të Pallatit të Kongreseve asnjë përfaqësues të opozitës, asnjë që mendon ndryshe për të folur e sjellë në tryezën e diskutimit ide, analiza dhe mendime se si mund të jemi të gjithë kontributorë në mënyrë të vërtetë për një arsim më të mirë, që të ndalim hemorragjinë e ikjes së të rinjve nga ky vend e boshatisjen

masive, që po bëhet plaga jonë më e madhe. Ishte kaq dëshpëruese të shikoje sesi të gjithë nxënësit ekselentë të shkollave tona kanë aplikuar të studiojnë jashtë shtetit me shpresën e një të ardhmeje me të mirë dhe me dëshirën e frikshme për të mos u kthyer më kurrë në Shqipëri!

Arsimi është në ditën e tij më të zezë dhe këtë e faktojnë edhe kambanat e alarmit që kanë filluar të bien për krizën e mësuesve. Të keqpaguar e të përdorur politikisht, askush nuk do të bëhet më mësues. Ditën e parë të shkollës isha në qytetin që përfaqësoj, në Krujën time, dhe pashë me sytë e mi se si deri më tani asnjë masë nuk është marrë për ngrohjen në shkolla, shtuar këtu edhe krizën energjetike. Ditët e ftohta të dimrit janë aty, dhe për shkollat në Krujë, por edhe në rang vendi, duhet një strategji dhe plan kombëtar për të përballuar dimrin.

Së fundi, dua të flas për pikturën tuaj të shëmtuar të hartës territoriale, e cila është një nga skandalet dhe treguesit më të mëdhenj të shkallës së korrupsionit, dalldisë politike dhe tragjikokomizmit që ka kapluar këtë qeveri. Nga kjo sallë e nga foltore dua t'ju bëj thirrje për ndryshime në reformën territoriale. Si përfaqësuese e qytetit të Krujës, kërkoj që Kruja dhe Fushë-Kruja të ndahen në dy bashki të veçanta. Ky është një propozim dhe një kërkesë e qytetarëve të Krujës, i vetëmjaftueshëm, me kriteret e afrisë së shërbimit për qytetarët, lidhjes kulturore e shpirtërore tradicionale, sigurisht, duke pasur parasysh edhe kriterin gjeografik. Ndarja aktuale nuk është asgjë tjetër veçse një ndarje politike, një inskenim i shëmtuar i demokracisë në emër të një reforme, e cila është një instrument në duart e Edi Ramës dhe përfaqësuesve të tij për të zgjatur sundimin me votat e vjedhura.

Këtë do ta vërtetojnë përsëri nëse nuk votojnë për ndryshimin e hartës territoriale. Kruja është një qytet të cilit duhet t'i japim rëndësinë që meriton, një qytet që i ka dhënë kaq shumë historisë dhe kombit shqiptar, është një qytet dinjitoz, që ka qenë në krye të frymës për demokraci dhe liri, ndaj meriton të ketë një status të veçantë. Është për të ardhur keq që, sidomos në 10 vjetët e fundit, ky qytet është shndërruar nga aset kombëtar në një vend të cilit po i venitet shkëlqimi i dikurshëm nga mungesa e investimeve, nga mungesa e punësimit, nga varfëria mbytëse dhe braktisja nga të rinjtë. Në Shqipëri është instaluar një kulturë ku të korrupuarit marrin vendime, bëjnë ç'të duan me ligjet, me fondet publike, me taksat dhe hapësirën publike.

Kjo gjë duhet të marrë fund. Ky nuk është vetëm një moment për llogaridhënie, por është edhe një moment për ndryshim. Shqiptarët nuk e meritojnë të udhëhiqen nga një qeveri e dalë me vota të vjedhura, nga një qeveri e zhytur në korrupsion dhe në krim, nga një qeveri që po i varfëron çdo ditë shqiptarët.